



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:066468

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766813

P.nr.275/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehuri A.S nga Peja, për shkak se ka kryer veprë penale „Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.436/2021 të datës 08.04.2021, në bazë të nenit 229 par.5, 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë shqyrtimit, me datë 31.05.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim me shenjën ND.nr.449/24 e lidhur me datë 21.05.2024 në mes të pandehurit (pala B) A.S nga Peja, me numër personal, dhe të dëmtuarit (pala A) V.O përfaqësues i me seli në Pejë.
- II. HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.436/21 të datës 08.04.2021.
- III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit A.S nga Peja, për veprë penale „Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, për shkak se i pandehuri dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.
- IV.** Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.436//21 të datës 08.04.2021, ndaj të pandehurit A.S nga Peja, për shkak se ka kryer vepër penale „Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me datë 21.05.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë, pas leximit të aktakuzës, gjykata sipas detyrës zyrtare konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale ka informuar palët se lënda penale mund të referohet në procedurën e ndërmjetësimit me pëlqimin e të pandehurit, të dëmtuarës dhe të Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët njëzëri janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 21.05.2024, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate në mënyrë që ta procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datë 21.05.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Kaltrina Rexhepi, ndërmjet të pandehurit (pala B) A.S nga Peja, me numër personal 1003663414, dhe të dëmtuarit (pala A) V.O përfaqësues i me seli në Pejë.

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarës palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush dhe nga kjo marrëveshje rezulton se i pandehuri do ta përbush detyrimin duke e paguar vlerën prej 11.794.17 euro në emër të dëmit që i është shkaktuar palës B dhe atë :shumën prej 1000 (njëmijë) euro pala A duhet ta paguaj me datë 03.06.2024, shumën prej 250 euro sipas marrëveshjes duhet paguar çdo muaj duke filluar nga data 05.07.2024 e deri me datën 05.07.2026. Shumën e mbetur i pandehuri obligohet ta paguaj si në vijim: nga 500 euro çdo muaj duke filluar nga data 05.08.2026 për të vazhduar çdo muaj e deri në përfundim të obligimit.

Njëkohësisht të pandehuri i shpreh keqardhje për rastin e ndodhur dhe njëkohësisht i kërkon falje të dëmtuarit-ës me ç ‘rast e dëmtuara e pranojnë kërkim faljen nga të pandehuri.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 21.05.2024, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.nr.449/24 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5, 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Departamenti I Përgjithshëm

Divizioni Penal

P.nr.275/2021, me datë 31.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.